

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Shqiptarët gjithmonë kanë qenë të shtrënguar të bëjnë një zgjedhje mes malit dhe detit! Mali është gjykuar si mundësi konservimi e izolimi, ndërsa deti rruga e bajlozit apo porta e hapur e rreziqeve. Gjithsesi, i kanë respektuar të dyja këto realitete, ashtu siç kanë ditur dhe siç kanë mundur, pa e futur në hasmëri atë çka natyra vetë përpoq. Politika e pushtimit dhe pushtuesit e politikës e kanë armiqësuar banorin e këtyre anëve me ujin e kripur, me peshkun, me turizmin, me ndihmat që mund të vinin e të shkonin nëpërmjet e prej tij si liri, si ekonomi, si kulturë, si komunikim. Të kurdisur me ideologji, si instrumente totalitarizmi përballë detit vendosëm bunkerë!

Pastaj në liri me ëndje e rendje i dhunuan brigjet, siç dinë vetëm oligarkët tanë, me këmbë, me duar, me nofulla dhe me dhëmballë, të cilët e urrejnë kapitalizmin me fytyrë njerëzore, sepse në disa raste ata janë vetë qenie pa fytyrë. Botën ata e matin me lartësinë e kërthizës dhe kërthizën e përdorin si qendër graviteti për botën. Pushteti lokal në ballë, ai qendror nga pas, duke kërkuar me ngulm vetëm një perspektivë, atë individualen, filluan ta rrahin detin me zinxhirë, si Kserksi perandori i lashtë persian. Vargonjtë e këtij zinxhiri të pakëputur janë oligarkët e rrethuar me hallexhinj, por të vetmuar kur numërojnë para dhe të shoqëruar me një apo dy dinjitarë zyrash kur ndajnë hiset.

E pati thënë Hasan Zykoja i gjorë: "Ç'e vërtit kadiu sherianë, kur ai sheh paranë!". Fjalëpakë, autoritarë, namuzqarë e të menduar, portrete balzakiane të babëzisë me kacidhet e Shqipërisë në xhepat e tyre, ata po shndërrohen në mitet e bashkohësisë sonë. Ne po i harrojmë shkrimtarët e artistët tanë, te këta të fundit bëjmë diferencime; atyre të Teatrit Kombëtar, që protestuan për shembjen fashistoide të tij, nuk ua ngremë rrogën, por i rrasim në turbinën soc-

realiste, ndonjë grupimi tjetër po, se ndenji më urtë. Natyrisht, emrat e Palok Kurtit, Prenkë Jakovës, Çesk Zadesë, Naim Frashërit, Kadri Roshit, Bujar Lakos, Ndrek Lucës, Agollit, Camajt, Arapit e të tjerëve edhe në këtë sallë do të shkaktojnë hutim, një ditë jo të largët ndonjë kolegë i ynë i ri do të pyesë: ku kanë ndërtuar këta? Cili është fshati i tyre turistik? Ç'hotel a markë sallami mban emrin e tyre?

Nga ana tjetër, do të dimë sa mace e pishina kanë manjatët e naftës; sa qen dhe apartamente kanë ata të kullave; sa lepuj e jahte kanë ata të bankave dhe sa ministra lepuj shëtisnin, hanin e lëpinin buzët teksa bënin hyzmet në të tilla akçihane. Lajkatarë e joshës, kur nevoja i thërret si dëshmorë të interesit, me mure llastiku, në vend të lëkurës së barkut, e cila zgjerohet befasisht, pa cak e kufij, ata e piskasin shtetin si kone ndaj plakës që shet domate, ndaj plakut 82-vjeçar, ndaj atij që proteston kur nga deti me motor i hyn në çadër dhe kur i thyejnë brinjët, apo edhe më keq, kur i mbysin fëmijën. Ata po e pinë detin me grykën si gjyryk nga Saranda në Velipojë, nga Shëngjini më Vlorë, nga Dhërmiu e Palasa në Orikum. Në këtë turravrap babëzie ata nuk janë vetëm.

Qeveria shqiptare i asiston, siç di ajo, me kujdes e devotshmëri për detajet. Nga miliona euro, që vijnë nga tjetërsimi i publikes në private, ata urrejnë të bukurën dhe të dobishmen e përbashkët në emër të së mirës vetjake, xhepit, trashëgimisë, pasurisë, por jo Shqipërisë. Shqipëria qenkësh vetëm për ta e fëmijët e tyre, si lopa larane për t'u mjellë nga një dorë rapaçe. Të tjerët janë qyqarë, zuzarë, shërbëtorë, sklevër e bij sklevërish, që pasuri e dinjitet nuk duan. Kësaj frote i jepet, u falet toka më e përshtatshme, hektarë të zgjedhur si investime strategjike për të bërë fshatrat e tyre turistikë me vila, që një njeriu të zakonshëm i duhen dy jetë për t'i blerë dhe një jetë për të kuptuar se çfarë po ndodh. Termat janë këta: "vitalizim", "rijetëzim", "zhvillim", "pasurim".

Detit ia shëmtuam tokën përreth, i premë pishat, nxorëm tapi të falsifikuara, ndërtuam pa kriter dhe të gjitha kategoritë e jashtëqitjeve i derdhëm në të me rropamë dhe përbuzje dhe në fund ngritëm çmimet, që shoqëria normale të rrijë larg si djalli temjanit, pranë detit e pafreskuar. Ata që jetojnë në breg të detit, vështirë të mos formojnë një mendim të vetëm ku deti nuk është pjesë e tyre. Të parët janë peshkatarët, të cilët e dinë se deti është i rrezikshëm,

dhe stuhitë janë të tmerrshme, por s'i kanë konsideruar ato arsye të mjaftueshme për të ndenjur në tokë, kur gjuetia bëhej me krahë. Ndërsa tani ata po rrinë në breg, në kafe, ku përtypin mërzi e varfëri bashkë. Nafta, kjo perpetuum mobile me çmimin e saj dhe monopolet mbi anijet e kanë shndërruar peshkatarin në të papunë, që ndonjëherë, rrallë, shumë rrallë ha peshk edhe nga ai i rezervatit grek.

Deti nuk ka ndjenja, nuk ka as mëshirë, ai sillet me ty ashtu siç ti sillesh me të. Sapo u fitua e drejta për t'u larguar nga qyteti, për të ikur nga mali, për të dalë nga lugina, e përdorëm detin si urë për të ikur dhe ai u ngri si Deti i Kuq në kohët e Moisiut, ndërsa shumë pak e përdorën për t'u kthyer. Po, Shqiptarët po ikin edhe nga deti, po i mbushin tragetet. Në lagje s'e gjen më berberin e vjetër, as shitësin e një jave më parë, te bari ku pi kafënë rutinë shkruhet: "Kërkojmë banakier dhe kamerierë, qoftë edhe pa përvojë". Kapitalizmi pa fytyrë njerëzore po e boshatis Shqipërinë. Qeveria me një fytyrë, sot sjell një ligj për të rregulluar punët në det, pasi në tokë i kreu të gjitha.

Dallgët fshijnë shkrimet në rërë, por jo firmat në letër. Rritja e çmimit të energjisë, barrë e rëndë për familjet, do të zgjidhej pjesërisht sikur t'i vendosej vetëm pak kufizim luksit të oligarkëve me paratë publike dhe jo lakun në fyt shtresës së mesme. Qeverinë s'e tremb bajlozi, se ai e ka xhan, i ndan gjërat me të, ndërsa Gjergji me të motrën kërkojnë azil në Londër. Dhe së fundi, shteti ynë mbeti pa ushkur, gati për t'u larë në det cullak, pasi hakerat i rrëmbyen çdo informacion, çdo shpresë dhe sekret, dhe bashkë me të edhe dinjitetin rojtarëve të tij, që s'ka dallgë që ua kthen mbrapsht, si rraqet nga anijet e mbytura plazheve dikur motit. Atë që e ka marrë lumi sot, e kërkoni kot në det, se deti u bë kos nga qeveria që rri pas meje. Faleminderit!